

Shkolla në Henc të Fushë Kosovës, e përfundoi një gjysëmvetor pa mësimdhënës të Edukatës Fizike

Nxënësit e paraleles së ndarë në shkollën fillore, “Bajram Curri”, në fshatin Henc të Komunës së Fushë Kosovës, një gjysëmvetor e kanë përfunduar pa mësimdhënës të Edukatës Fizike.

Që nga shtatori i vitit 2021 e deri në mesin e janarit të këtij viti fëmijët nuk kanë pasur të angazhuar mësimdhënës për këtë lëndë.

N. Sh. prindi i një vajze që i ndjekë mësimet në shkollën “Bajram Curri”, në fshatin Henc, ka thënë për KALLXO.com, se mungesa e mësimdhënësit ka zgjatur gjatë gjithë gjysmë vjetorit të parë dhe tri javët e para të gjysmë vjetorit të dytë.

Ai shtoi se shkaqet kanë qenë të panjohura për të si prind dhe për vajzën e tij.

“Unë si prind jam njoftuar pothuajse disa herë nga vajza ime, nxënëse e klasës së tetë në PNF (Paralelja e Ndarë Fillore) shkolla fillore ‘Bajram Curri’ në fshatin Henc, lidhur me mungesën e arsimtarit të lëndës së Edukatës Fizike. Arsyet për këtë mungesë e cila, fatkeqësisht, ka zgjatur përgjatë krejt gjysëmvetorit të parë të vitit shkollor 2021/2022 dhe ka vazhduar edhe në gjysëmvetorin e dytë (deri në javën e tretë të Janarit 2022), kanë qenë gjithmonë të panjohura, si për vajzën ashtu edhe për mua si prind”, tha ai.

N. Sh. tha se notimi është kryer nga një mësimdhënës i shkollës amë në Sllatinë.

“Sa i përket mënyrës së notimit të nxënësve për gjysëmvetorin e parë në mungesë të arsimtarit në fjalë, sipas asaj çfarë më ka thënë vajza ime, ka qenë një arsimtar tjetër i lëndës së Edukatës Fizike nga shkolla amë në Sllatinë i cili e ka marrë përsipër notimin e nxënësve në PNF Henc”, shtoi ai.

Këtë informacion e kanë konfirmuar për KALLXO.com drejtori i shkollës Tahir Shabani dhe drejtori i Arsimit në Komunën e Fushë Kosovës Samir Shahini.

Drejtori i kësaj shkolle në një deklaratë të dhënë për KALLXO.com më 19 janar, kishte thënë se që nga shtatori i vitit të kaluar kanë mbetur pa mësimdhënës të Edukatës Fizike, për klasat 6 deri te klasa e 9-të.

“Nuk ka pas mësimdhënës të edukatës fizike dhe ende nuk kemi. Arsyet janë se po përsëritet konkursi. Prej shtatorit personi e ka ndërruar vendin e punës ka shkuar në tjetër shkollë. Prej klasës 6 deri te klasa 9-të janë 4 klasë”, tha Shabani.

Sipas drejtorit të shkollës mënyra e vlerësimit të nxënësve është bërë me një mësimdhënës tjetër i cili sipas tij i ka mbajtur disa orë me nxënësit dhe i ka vlerësuar.

“E kemi dërguar një arsimtar prej qendrës i kemi mbajtur disa orë me të dhe jemi mundu m`i vlerësu nxënësit në atë mënyrë”, tha ai.

Sipas Shabanit, konkursi është hapur 3 herë dhe tani sipas tij është përzgjedhur një kandidat të cilin ende po e presin.

Drejtori i Arsimit në Komunën e Fushë Kosovës Samir Shahini, tha për KALLXO.com se çështja e përzgjedhjes së mësimdhënësit tashmë është rregulluar.

Shahini në përgjigjen e kthyer për KALLXO.com më 19 janar, tha se para vitit të ri është shpallur konkursi dhe kanë përfunduar gjitha procedurat.

“Tash e tri javë është rregulluar kjo çështje. Para vitit të ri është shpall konkursi por deri sa janë përfunduar procedurat. I ka dy javë që ka fillu punëtori i ri i Edukatës Fizike që e mbulon edhe paralelen në fshatin Henc edhe paralelen në fshatin Miradi e Epërme”, tha drejtori i Arsimit i kësaj komune.

Sipas Shahinit, një konkurs i hapur më 20 shtator 2021 për pozitën mësimdhënës i Edukatës Fizike është [anulluar](#) në dhjetor të këtij viti për arsye që kjo procedura ka mbetur në gjysmë nga paraardhësi i tij.

“Procedurat kanë mbet në gjysmë kur kam ardh unë në dhjetor i kom fillu menjëherë procedurat dhe ka fillu me kohë”, tha ai.

Ndërkaq, më 22 dhjetor, është hapur konkurs për plotësimin e disa vendeve të lira të punës për disa lëndë të ndryshme në nivel komunal, në mesin e tyre edhe pozita për mësimdhënës të Edukatës Fizike.

Sipas drejtorit të Arsimit Samir Shahini, kandidati i përzgjedhur nga komisioni është Leutrim Sllamniku.